



**ODA E INXHINIERËVE
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës Komora Inženjera Republike Kosovo Chamber of Engineers of the Republic of Kosovo	
Regjistri (Reg.): Org. Jem. (Mesa): Org. Unit:	Mr. I Prot. Brog Prot. Prot. No. <u>318/2026</u>
Nr. I Kërkesës E. Shtetësisë Nr. Pages:	Data: Datuar: Date: <u>13.05.2026</u>
PRISHTINË / A. No.1	

Nr. 13-BD/2026
Prishtinë: 12.05.2026

Bordi Drejtues i ODËS SË INXHINIERËVE NË FUSHËN E NDËRTIMIT, me numër fiskal 603383324, në mbështetje të: nenit 17 të LIGJIT NR. 08/L-012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit; nenit 24 të STATUTIT TË ODËS SË INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR PERIUdhËN E PËRKOshME, të miratuar më datë 31.12.2024, me numër protokollit 8648/24; me qëllim të standardizimit të procedurës për paraqitjen, evidentimin, protokollimin dhe trajtimin e kërkesave administrative, profesionale, disiplinore, ankesave dhe parashtresave të tjera në Odën e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës, si dhe duke u bazuar në vendimin e miratuar nga Bordi Drejtues në mbledhjen e mbajtur më datë 31.03.2026 dhe të evidentuar në procesverbalin/minutat e takimit të kësaj mbledhje, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë 12.05.2026, nxjerr këtë:

VENDIM

1. Miratohet Formulari Zyrtar për Paraqitjen e Kërkesave në Odën e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës, i cili do të përdoret për paraqitjen dhe trajtimin e kërkesave administrative, profesionale, disiplinore, ankesave, sugjerimeve, iniciativave dhe kërkesave të tjera që i drejtohen organeve dhe administratës së OIRK-së.
2. Formulari zyrtar i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Çdo kërkesë, ankesë apo parashtresë që paraqitet për trajtim në Bordin Drejtues, Komisionet e Odës apo Administratën e OIRK-së, duhet të dorëzohet përmes formularit zyrtar të miratuar me këtë vendim.
4. Formulari ka për qëllim: standardizimin e procedurës së paraqitjes dhe trajtimit të kërkesave; sigurimin e dokumentimit dhe evidencimit administrativ të parashtresave; garantimin e trajtimit profesional, transparent dhe të bazuar në dokumentacion dhe bazë ligjore; lehtësimin e shqyrtimit dhe vendimmarrjes nga organet kompetente të Odës.
5. Administrata e OIRK-së obligohet që: të pranojë dhe protokollojë kërkesat e paraqitura përmes formularit zyrtar; të verifikojë plotësimin formal të formularit dhe dokumentacionit mbështetës; të kërkojë plotësimin e dokumentacionit në rast të mungesave; t'i procedojë kërkesat organit kompetent për shqyrtim dhe vendimmarrje.
6. Kërkesat, ankesat apo parashtresat të cilat: nuk paraqiten përmes formularit zyrtar; nuk përmbajnë të dhënat e nevojshme; nuk kanë të bashkëngjitur dokumentacionin mbështetës të kërkuar; nuk përmbajnë arsyetim apo bazë përkatëse ligjore kur kërkohet; nuk konsiderohen kërkesa zyrtare për trajtim dhe mund të mos procedohen apo shqyrtohen nga organet e OIRK-së deri në plotësimin e tyre në përputhje me këtë vendim dhe aktet e Odës.
7. Formulari publikohet në ueb-faqen zyrtare të OIRK-së dhe mund të dorëzohet në formë fizike ose elektronike, në përputhje me procedurat administrative të Odës.
8. Ky vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit Mbikëqyrës.
- Anëtarëve Themelues të Odës.



**ODA E INXHINIERËVE
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

- Arkivit të OIRK-së.

Bordi Drejtues i OIRK-së:

1. **Arsim Rapuca**, Kryetar i OIRK-së _____ 
2. **Mimoza Shahini**, Anëtare e Bordit Drejtues të OIRK-së _____ 
3. **Kadri Morina**, Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së _____ 
4. **Afrim Demiri**, Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së _____ 
5. **Nebi Pllana**, Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së _____ 
6. **Bujar Jupaj**, Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së _____ 
7. **Sami Kolgeci**, Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së _____ 

FORMULAR ZYRTAR PËR PARAQITJEN E KËRKESAVE

I. TË DHËNAT E PARASHTRUESIT

- Emri dhe Mbiemri: _____
- Numri i licencës: _____
- Profili profesional: _____
- Numri i telefonit: _____
- Email: _____

II. LLOJI I KËRKESËS

(Shënoni me ✓)

- Administrative
- Profesionale
- Disiplinore
- Ankesë
- Sugjerim / Iniciativë
- Tjetër: _____

III. KATEGORIZIMI I KËRKESËS

(Obligative)

Kërkesa klasifikohet si:

- Ligjore
- Administrative
- Teknike/Profesionale
- Disiplinore
- _____

IV. BAZA LIGJORE E KËRKESËS

(Obligative për kërkesa formale dhe ankesa)

Neni i ligjit / statutit / rregullores ku bazohet kërkesa:

V. PËRSHKRIMI I KËRKESËS

(Plotësohet në mënyrë të strukturuar)

1. Situata faktike:

2. Problemi konkret:

3. Kërkesa specifike ndaj Odës:

VI. ARSYETIMI I KËRKESËS

VII. DOKUMENTET SHOQËRUESE

- Lista e dokumenteve të bashkëngjitura:
-

(Dokumentet janë të obligueshme në rastet disiplinore dhe ankesat)

VIII. DEKLARATË

Unë deklaroj se:

- të dhënat e paraqitura janë të sakta dhe të plota;
- kërkesa është e bazuar në fakte dhe në përputhje me aktet e Odës;
- mbaj përgjegjësi për çdo pasaktësi ose keqpërdorim të procedurave të Odës.
- Emri dhe Mbiemri: _____
- Nënshkrimi: _____
- Data: ____ / ____ / _____

IX. PLOTËSOHET NGA ADMINISTRATA E OIRK

- Numri i protokollit: _____
- Data e pranimit: ____ / ____ / _____
- Pranuar nga: _____

X. SHËNIME ZYRTARE

- Kërkesat mund të dorëzohen në formë fizike ose elektronike.
- Kërkesa konsiderohet zyrtare vetëm pas:
 - plotësimit të këtij formulari, dhe
 - regjistrimit në protokollin e Odës.
- Për lehtësimin e trajtimit administrativ, rekomandohet dorëzimi fizik i formularit në administratën e Odës.
- Komunikimet përmes email-it, pa këtë formular dhe pa protokollim, nuk konsiderohen kërkesa zyrtare dhe nuk trajtohen.
- Kërkesat që:
 - nuk janë të strukturuar,
 - nuk përmbajnë bazë ligjore,
 - nuk kanë dokumente mbështetëse (kur kërkohet),

mund të refuzohen pa shqyrtim.